Asambleja
01.Nr.V
Deçan,dt.20.05.2020

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e V-të të rregullt të Asamblesë Komunale , me dt.20.05.2020.
Në mbledhje ishin prezent:24 anëtarë të asamblesë, Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, OSBE, OJQ, mediat.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, zotëri Haki Shehaj.
Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt.02.03.2020,
2. Njoftim për aktivitete e Komunës gjate kohës se pandemisë,
3. Ri-Shpallja zone me interes për komunën e pronës së Pushimores se fëmijëve ne Deçan dhe shprehja e interesit te Komunës qe ketë prone ta merr ne menaxhim sipas procedurave të ligjeve ne fuqi,
4. Aprovimi i mjeteve financiare për hartimin e raportit vlerësues mbi vlerësimin e dëmit ekonomik për prodhuesit dhe bizneset e komunës te shkaktuara nga Covid 19, Vlerësim i cili do te behet nga Kompania N.SH."Insitute For Entrepreneurship And Smail Business",
5. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e V-të të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje janë prezent 24 asambleist (mungojnë: Erblina Tahiraj, Uran Tolaj, Shkelqesa Hadergjonaj).
Kryesuesi- e ka prezentu rendin e ditës.
Milazim Mushkolaj- ka pase vërejtje pse ne sallë mungojnë simbolet e shtetit.
Kryesuesi- ka thënë se ende nuk kane përfunduar krejt punimet e renovimit te sallës prandaj edhe simbolet nuk janë vendose ende, pastaj e qiti ne votim rendin e punës i cili njëzëri miratohet nga asamblistët.
I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Miratohet njëzëri pa vërejtje.
II. Njoftim për aktivitete e Komunës gjate kohës se pandemisë.
Kryetari i Komunës, zotëri Bashkim Ramosaj, ka kërkuar qe sot mos te folim per pandeminë sepse do ta sjellim raportin detal ne mbledhjen e radhës ne te cilin do te prezantohet saktësisht çka kemi punuar gjatë kohës se pandemisë.
Asamblistët u pajtuan qe kjo teme mos te debatohet sot por mbledhjen e radhës te vjen raporti.
III. Ri-Shpallja zone me interes për komunën e pronës së Pushimores se fëmijëve ne Deçan dhe shprehja e interesit te Komunës qe ketë prone ta merr ne menaxhim sipas procedurave të ligjeve ne fuqi.
Kryesuesi-e ka prezentu piken pastaj për sqarime e ka ftuar Kryetarin e Komunës.
Kryetari-ka sqaruar se ditë më parë jemi njoftuar nga AKP-ja se kane filluar aktivitetin e likuidimit te pronës se Pushimores se fëmijëve ne Deçan, dhe unë si Kryetar ka thënë ai kam kërkuar qe kjo procedure te pushon sepse ne si komune kemi interes qe Pushimoren e fëmijëve ta marrim ne menaxhim, ne para jush sot e kemi sjelle propozimin i cili prezenton synimin tone e pastaj pas këtij vendimi do te fillon procedura e shpronësimit për këtë prone e cila është shumë me rëndësi për zhvillimin e Deçanit, ne fund kryetari i ka ftuar asamblistët qe ta votojnë këtë propozim.

Florim Mataj- thot se duke u nisur nga sqarimet qe u thane nga kryetari propozoj qe kjo pike te qitet ne votim dhe te vazhdojmë me pikat tjera.
Ilir Ferizaj- thot se nuk kam informacione qe ka qene e shpallur nga AKP kjo prone, pastaj shtron pyetjen se cili ka me qene implikimi juridik me Manastirin për ate prone.
Kryetari- sqaron se qe nga viti 2010 ne kemi filluar me procedurat e shpalljes si zone me interes për komunën, e kemi rishpalle edhe ne vitin 2018 dhe kjo është hera e trete dhe ne nuk kemi asnjë kontest me aske e aq me pak me Manastirin.
Mon Selmonaj-thot se si grup parlamentar i PDK-së e mbështesim këtë propozim dhe është koha qe te bëjmë diçka ne këtë drejtim, si kuvend ne këtë çështje duhet te jemi unik dhe ne favor te këtij propozimi.
Meqenëse nuk kishte diskutime tjera Kryesuesi e qiti ne votim propozimin për Ri-Shpallje zone me interes për komunën të pronës së Pushimores se fëmijëve ne Deçan dhe shprehja e interesit te Komunës qe ketë prone ta merr ne menaxhim sipas procedurave të ligjeve ne fuqi, anëtarët e kuvendit njëzëri e miratojnë atë.
IV. Aprovimi i mjeteve financiare për hartimin e raportit vlerësues mbi vlerësimin e dëmit ekonomik për prodhuesit dhe bizneset e komunës te shkaktuara nga Covid 19, Vlerësim i cili do te behet nga Kompania N.SH."Insitute For Entrepreneurship And Smail Business".
Kryesuesi-e ka prezentu piken pastaj ka thënë se mjetet nevojiten për hartimin e një raporti i cili paraqet demin ekonomik te shkaktuara nga covid 19.
Kryetari- thot se jemi komuna e vetme qe kemi përdorë metodologjinë e sakte për këtë pandemi, duke marre parasysh deklarimet e qeverise se Deçani nuk ka nevojë te ndihmohet sepse nuk ka pasë raste te infektuara, mirëpo ne duhet me vepru sakte me letra –me vlerësimin për humbjet qe kemi pësuar ne këtë kohe pandemie, ai thot se ne kemi bere një para-marrëveshje me kompaninë ne fjale për hartimin e një raporti vlerësues por ky dokument duhet ta ketë miratimin e juve po ashtu edhe punën e juve sepse ju mund te punoni bashk me kompaninë te ndare ne katër grupe dhe aty te përfshihen te gjitha aktivitetet e kryera gjate kohës se pandemisë ne komunën e Deçanit, ne kemi pasur gjate kësaj kohe njerëz qe na kane mbështetur me ndihma por qe kanë kërkuar te mbeten anonim dhe mos t'iu përmendet emri.
Kestrim Avdimetaj-thot se ne parim kostoja është shumë e larte dhe duke u nisur nga aftësia e asamblistëve unë mendoj se ne mund ta bëjmë vlerësimin te ndare ne grupe.
Kryetari- thot se ne kemi shkuar me çmim me te ulet se komunat tjera sepse ju mund te informoheni me kostot e komunave tjera, mirëpo për me qene një dokument kredibil duhet me qene hartuese e raportit një kompani e licencuar.
Erdogan Dautaj-thot se e përgëzoj kryetarin për punën e bere mirëpo e përkrahi edhe Kestrimin për propozimin e bere por mendoj se ma mire është qe bartëse e kësaj te jete një kompani, ndërsa ne vazhdim ai propozon qe te lirohen nga qeraja te gjitha objektet komunale te dhëna me qera duke përfshi këtu edhe terasat për një periudhe tremujore ose ma gjate.
Florim Mataj- thot se eshte mire te qartësohet se a do te shkojnë familje për familje apo vetëm me biznese te regjistruara, e përkrahi propozimin e Erdoganit për lirim nga qeraja dhe kërkoj qe kjo te behet si komuna e Prishtines deri ne dhjetor 2020.
Milazim Mushkolaj- thot se kjo është gjë e mire qe raporti te hartohet nga një kompani por është mire qe edhe komuna te bën grupet e veta punuese qe te ndihmojnë kompaninë qe te mos harrohet asgjë qe duhet pa u përfshi.
Kryetari- kërkon nga asamblistët qe te formojnë grupet e veta e pastaj te përfshihet edhe ekzekutivi.
Ilir Ferizaj- propozon qe kjo pune te behet me procedure te prokurimit dhe ndoshta nuk ka pas nevojë për këto procedura.
Kryetari- thot se kjo nuk është e planifikuar dhe duhet te miratohet ne kuvend.
Shkelqim Haxhnikaj-thot se profesori i cili është pjesë e stafit të kompanisë është shum i mire prandaj ju përgëzoj për përzgjedhjen e kompanisë, e përkrahi propozimin për lirimin nga qeraja te objekteve komunale deri me 31 dhjetor te këtij viti.

Albesa Cacaj-e përkrahi propozimin për lirim te objekteve komunale nga qeraja por ne ende nuk e dimë cilat janë pronat komunale.
Kryetari- ka dhënë sqarime.
Mon Selmonaj-thot se e mbështes ne parim këtë propozim dhe kam besim se do te jete një raport profesional zyrtar i detajuar për demet te cilat janë shkaktuar gjate pandemisë, jam pak skeptik sepse bizneset tona nuk i kan lajmëruar krejt te dhënat , mirëpo me gjith ate e mbështes propozimin mirëpo kërkon sqarim se ku do ti marrim këto 20.000 €.
Albana Avdiu- thot se është shum e nevojshme hartimi i këtij raporti, e falënderoj kryetarin me grupin e vet për aktivitetet dhe punët e kryera gjate pandemisë , është mire me na ndihmu qeveria ne baze te këtij raporti por ne mund te kërkojmë mbështetje edhe ne burimet tjera, me rëndësi është qe ta kemi si dokument.
Ilir Ferizaj- thot se jam pak skeptik se çka do te behet pas këtij raporti.
Kryetari- ne duhet ta kemi raportin e pastaj te shofim, na e kemi për obligim qe ta kemi këtë dokument dhe me trokite ne te gjitha portat ku mund te na përkrahin.
Kryesuesi-thot se Deçani i ka zbatu masat kufizuese gjate pandemisë dhe si rezultat i kësaj shum biznese janë mbylle dhe ekonomia është dëmtuar shum, dhe ky është një projekt dokument qe do te konkurrojmë me te.
Valdet Nuraj- se pari kërkon qe paraprakisht te shkruhen emrat e delegatve me radhe ashtu si e kërkojnë fjalën sepse disa nuk po mund ta marrim fjalën kurse disa te tjerë e marrin disa here radhazi, pastaj ka thënë se bashkëpunimi i komisioneve te kuvendit dhe ekzekutivit nuk po vjen ne shprehje nga një here si për shembull ne e kemi pase formu një komision për dhënie ne shfrytëzim te Eco tregut, dhe nuk jemi pyet fare per ate çështje ndërsa dëgjojmë se Eco Tregu është dhënë ne shfrytëzim.
Kryesuesi- thot se e kemi propozimin e Erdogan Dautaj për lirimin e objekteve komunale nga qeraja si dhe propozimin per ndarjen e mjeteve financiare për hartimin e raportit vlerësues mbi vlerësimin e dëmit ekonomik për prodhuesit dhe bizneset e komunës te shkaktuara nga Covid 19, Vlerësim i cili do te behet nga Kompania N.SH."Insitute For Entrepreneurship And Smail Business".
Kryesuesi e qiti ne votim propozimin per ndarjen e 20.000 € per hartimin e raportit vlerësues mbi vlerësimin e dëmit te shkaktuar nga Covid 19, antaret e kuvendit e miratojnë me shumic votash, rezultati i votimit ishte 22 per 2 apstenim.Në vazhdim kryesuesi e qiti ne votim propozimin për lirim nga qeraja te objekteve komunale te dhëna me qera, anëtarët e kuvendit njëzëri marrin vendim për lirim nga qeraja te objekteve komunale te dhëna me qera, lirimi do te behet duke filluar nga muaji mars deri me 31 dhjetor te këtij viti.
V.Të ndryshme.
1.Shqyrtimi i kërkesës së fshatit Gllogjan per ndërtimin e lapidarit të 5 dëshmorëve: Luan Qerimaj, Rexhep Tafaj, Besim Alijaj, Fetah Selca dhe Haki Krasniqi, në vendin e rënies, ne shumen prej 6,000.00 €.
Kryesuesi- e prezentoj kërkesën e cila është shqyrtuar dhe përkrahur ne KPF dhe me rekomandim te KPF-se ka ardhë ne Kuvend për arsye qe shuma e kërkuar për aprovim është kompetence e kuvendit, Kryesuesi ka sqaruar se pjesa e madhe e mjeteve te nevojshme për ndërtim te lapidarit është sigurua nga familjaret e dëshmorëve, kërkesa është qe komuna te participin aty me 6000 €.
Albesa Cacaj- thot se parimisht jam pe rate qe te përkrahen kërkesat e tilla, mirëpo vërejtja ime është se kërkoj te trajtohen njëjtë te gjithë dëshmorët dhe mos te kete favore askush.
Kryesuesi- thot se pajtohem me ate qe te gjith dëshmorët te trajtohen njëjtë, mirëpo sot e kemi kete kërkesë e cila meriton te miratohet ndërsa ne te ardhmen te gjitha kërkesat e kësaj natyre qe i drejtohen KPF-se dhe Kuvendit do te kenë te njëjtin trajtim.
Valdet Nuraj- thot se qe 12 vjet kam punuar ne Shoqatën Veteranëve dhe e them me përgjegjësi te plote qe te gjitha kërkesat qe i ka pru komuniteti ne i kemi trajtu njëjtë dhe asnjëherë nuk ka pase ndasi këtu, jam i mendimit qe edhe këtë kërkesë duhet ta përkrahim.

Florim Mataj- fillimisht thot i falënderoj familjaret qe i kan tubu mbi 70 % te mjeteve dhe kërkoj qe edhe këto te miratohen sot.
Ilir Ferizaj- thot se askush nuk është kundër lapidarëve por për momentin jemi ne kohe te papërshtatshme dhe ndoshta nëse e kishim shty pak qe te shofim si jemi me mjete buxhetore nuk kishte pasur ndonjë problem.
Erdogan Dautaj- ne emër te AAK-se kërkon qe te qitet ne votim.
Kryesuesi-e qiti ne votim kërkesën e komunitetit te fshatit Gllogjan per ndërtim te lapidarit te 5 deshmoreve ne vendin e rënies, ne shumen prej 6000 €, anëtarët e kuvendit e miratojnë me shumic votash, rezultati i votimit ishte 22 per, 1 kunder dhe 1 apstenim.
Florim Mataj- propozon qe ne mbledhjen e radhës te hyn ne rend dite si pike e veçantë – Caktimi i lokacionit per ndërtimin e objektit turistik ne bjeshke te Belegut, me arsyetimin se ky vendim është marre ne shkurt te këtij viti mirëpo është ndërruar lokacioni për te cilin kemi marre vendim dhe për lokacion tjetër kërkohet vendim i ri.
Miratohet propozimi i Florim Mataj dhe mbledhjen e radhës duhet te futet si pike e veçantë e kuvendit – Caktimi i lokacionit për ndërtim te objektit turistik ne bjeshke te Belegut.
Milazim Mushkolaj-ka ngrite çështjen e mungesës se ujit te pijes ne 11 fshatra dhe ka kërkuar sqarim për këtë çështje .
Kryesuesi- tha qe ne si kuvend kërkojmë nga përfaqësuesi i kompanisë Ujësjellësi qe te vjen këtu ne kuvend mbledhjen e radhës dhe te na njofton për mungese te ujit, anëtarët e kuvendit pajtohen qe drejtori i ujësjellësit mbledhjen tjetër ne kuvend te ep sqarime për mungesën e ujit te pijes ne 11 fshatra.
Rifat Stojkaj, drejtor i drejtorisë për BPZHR- ka sqaruar ne lidhje ne çështjen e ngritur me herët nga Valdet Nuraj për hapjen e Eco Tregut, ai ka pohuar se është e vërtetë qe është formuar komisioni për zhvillimin e procedurave për dhënie ne shfrytëzim te Eco tregut, mirëpo meqenëse ka qene kohe e pandemisë dhe për shkak te interesit te fermerëve e kemi funksionalizu Eco tregun, i cili do te qëndron i hapur gjate kësaj kohe te pandemisë dhe pas përfundimit te kësaj gjendje ne do ti zhvillojmë te gjitha procedurat e dhënies ne shfrytëzim sipas ligjit ne fuqi.
Mehmet Osaj- ka kërkuar qe mbledhjen tjetër te diskutohet rreth çështjes se pronave ne Podin e Gështenjave dhe Osbilit.
Mon Selmonaj- thot se kërkesa per shqyrtim te çështjes se Podit te Gështenjave dhe Osbilit duhet te vjen ne kuvend me nënshkrimet e qytetarëve.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse:
Dyke Llolluni

Verifikon procesverbalin:

Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj

Asambleja
01.Nr.VI
Deçan,dt.30.06.2020

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e V-të të rregullt të Asamblesë Komunale , me dt.30.06.2020.
Në mbledhje ishin prezent: anëtarët e asamblesë, disa drejtor të drejtorive komunale,KFOR, mediat.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, zotëri Haki Shehaj.
Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kornizes Afatmesme Buxhetore (KAB) 2021-2023,
3. Shqyrtimi i raportit per aktivitetet e Komunes gjate kohes se pandemise COVID - 19,
4. Vlersimi ekonomik i ndikimit te te pandemise Covid 19,
5. Aprovimi i mjetve financiare per projektin Zhvillimi i shtegut te ngjitjes sportive "Via Ferrata Decani", ne shumen prej 20.000 euro,
6. Ndarja e mjeteve financiare per hapjen dhe mirembajtjen e kanaleve te ujitjes ne bashkefinancim me K.R.U."Drini i Bardhe", ne shumen prej 11,000 euro,
7. Shqyrtimi i kerkeses se Keshillit te Bashkesise Islame ne Deqan per ndertimin e Xhamise ne fshatin Rastavice, ne ngastren kadastrale nr.P-722-0,
8. Shqyrtimi i kerkeses se OVL ne Deçan dhe marrja e vendimit per emertimin e vendit Batalioni Gardist "Shkelzen Haradinaj" ne vendin e renies se 16 Dëshmorëve në Bjeshkë të Belegut,
9. Plani i Veprimit për Komunitetet Egjiptian, Ashkali dhe Rom në Komunën e Deçanit 2020-2022,
10. Te ndryshme

Me rekomandim te KPF-se jane shqyrtuar edhe keto tema:

11. Zhvendosja e Mullirit te Shabanaj,
12. Kerkesa e fshatit Strellc per rivarrim te deshmorve ne vlere prej 42.000 euro, tash do te zotohen 5000 euro ndersa te tjerat ne shtator do te planifikohen me buxhet.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e VI-të të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje janë prezent 24 asambleist .

Kryesuesi- e prezentoj rendin e punës si dhe njoftoj se me rekomandim te KPF-s pika nr.7 – Shqyrtimi i kerkeses se Keshillit te Bashkesise Islame ne Deçan per ndertimin e Xhamise ne fshatin Rastavice, ne ngastren kadastrale nr.P-722-0, rekomandohet te hiqet nga rendi i dites ndersa me kerkesen e Kryetarit te Komunes rekomandohet qe ne rend dite te futet-Zhvendosja e Mullirit te Shabanaj, si dhe Kerkesa e fshatit Strellc e prezentuar nga Valdet Nuraj per ndarjen e mjeteve financiare per rivarrosjen e Dehsmorve te fshatit Strellc te Lapiodari i fshatit-shuma e mjeteve te kerkuara 42.000 euro.

Mehmet Osaj- thot qe per mulli kemi vendose pse prap te debatohet per te.
Kryesuesi- ka thene qe poashtu e kemi edhe nje kerkese nga KPF qe sot ne kete mbledhje te raporton drejtori i Ndermarrjes Higjiena per 50.000 euro qe kesaj ndermarrje i jane nda me vendim te Kuvendit per te operuar gjate kohes se pandemise, si dhe eshte kerkese e drejtorit te Ndermarrjes Higjiena qe pika e tij te jete e para ne rend dite per shkak te obligimeve qe ka.Kryesuesi i qiti ne votim pikat e propozuara nga KPF , antaret e Kuvendit i miratuan ato njëzëri, drejtori i Ndermarrjes Higjiena raporton i pari.
Florim Mataj- thot qe kerkesa ime mbledhjen e kaluar ka qene qe ne kete mbledhje te debatohet-jo te caktohet lokacioni per projektin te cilin ne mbledhjen e muajit shkurt 2020 ne kuvend na eshte prezentuar nga Kryetari i Komunes ne piken Te ndryshme nje projekt per ndertimin e nje shtepie tip bujtine per shoqaten e Bjeshkatarve te Deçanit dhe per shumari ku na eshte thene se do te ndertohet ne bjeshke te Belegut ne piken kufitare.Arsyetimi i Kryetarit ka qene qe ne e kemi nje donacion dhe nuk eshte mire qe ta humbim, une dhe te gjith asamblistet e kemi votuar kete propozim.Ne vazhdim ai i eshte drejtuar kryetarit te komunes me kerkesen qe te prezentohet ne kuvend projekti me te dhena te detajuara duke kerkuar edhe ne cilen faze te implementimit eshte, sa siperfaqe toke do te kalojne ne pronesi te ketij objekti, a eshte ndertim i vrazhde apo ndertim nga guri apo druri dhe ne pronesi te kujt realizohet projekti i tille.kush do ta menagjon kete projekt, a do te kete komuna e Deçanit ndonje perfitim apo obligim financiar si gjate ndertimit por edhe pas ndertimit te ketij objekti.Duke bartur pergjegjsine e votimit ka thene ai kerkoj qe ky projekt te realizohet ne permasa dhe kushtet qe eshte votuar pra ne bjeshke te Belegut.Zoti Kryetar ka thene ai, sipas informatave flitet se objekti ka filluar te ndertohet ne Bjeshke te Babalioqit dhe kjo ka nxitur shqetsim te une dhe tek banoret e fshatit Babalioq duke u revoltuar qe une kam votuar nje projekt pa diskutim paraprak dhe miratim nga bashkfshataret e mi.Duke konsideruar qe ky objekt ka filluar te ndertohet ne lokacion tjeter nga lokacioni qe eshte votuar ne asamble une kerkoj nga ju zoti kryetar qe per tu realizuar ky projekt ne Bjeshke te Babalioqit duhet qe paraprakisht te diskutohet me banoret e fshatit Babalioq si dhe te sjellet ne Kuvend per votim.Ne te kunderten ai eshte i jashtligjshem pasi qe nuk eshte votuar ne asamble dhe ne keto rrethana nuk e ka perkrahjen dhe voten time.Andaj si asmblist ndihem i obliguar dhe do te jem zeri i bashkfshatarve te mi.Do te perkrahi qdo veprim qe marrin banoret e fshatit Babalioq per te realizuar te drejten qe na takon qofte me protesta por edhe rruge tjera ligjore.Ne vazhdim ai ka kerkuar qe te insistohet nga Komuna dhe asambleja te Kuvendi i Kosoves per ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-086 per Parkun Kombetar Beshket e Nemura.Poashtu ai ka ngrite edhe qeshtjen ku vite me heret nga Komuna e Deqanit fshatit Babalioq ju ka marre dhe nderru Suka e fshatit me nje prone ne Deçan eshte shkemby me AKP pa i pyetur fare banoret e fshatit, vitin e kaluar me insistimin tim dhe perkrahjen e asambles dhe ndihmen tuaj zoti kryetar ne asamble e kemi shpallur zone me interes per komunen dhe kerkoj nga ju kryetar qe te insistoni qe te vazhdojme me procedurat dhe Suka e Babalioqit ti kthehet komunes dhe te shfrytezohet nga banoret e fshatit per kullotat e bagetise.
Natyra Kuçi- ka thene se nuk i eshte perfshi te rekomandimet e KPF-s te pika –Plani per komunitet Rom, Ashkali Egjiptian, diskutimi i saj dhe mospajtimet qe ka pase me drejtorin e Drejtorise per buxhet dhe financa, ajo eshte shprehur-Une boj thirrje qe Agron Demukaj me kerku falje publike ose kjo teme nuk mbyllet me kaq.Si PSD du qe ai person me kerku falje sepse komuniteti RAE jane qytetar te barabarte te kesaj komune e jo te quhen "gabel" dhe maxhup".
Kryesuesi- i ka sqaruar Natyra Kuçit, se ne mbledhjen e KPF-se pasi qe ajo ka dale nga mbedhja une si kryesues i KPF-së kam thene se ai komunitet kane dhene kontribut te veqante per lirine e Kosoves dhe jane te barabarte me ne.
Agron Demukaj- ka thene se dje kam citu se komuniteti RAE pra Rom Ashkali dhe Egjiptian jane qytetar te barabarte, une ne kontest me kohen e luftes kam deklaruar per personat te cilët ne vitet 98-99 na i kan djegur shtëpitë dhe u kam thene atyre " Gabel dhe maxhup" te cilët kan bashkëpunuar me paramilitaret e jo ne asnjë menyre nuk i kam ofenduar e aq me pak akuzuar komunitetin e sotëm RAE, por une duke u nisur nga etika familjare ne mënyrën me te sinqert kërkoi falje jo vetëm publike por edhe morale nëse eventualisht jam keqkuptuar nga ndonjë

individ.
Mon Selmonaj- fillimisht thot du te nderlidhem me diskutimin dhe kerkesen e Florim Mataj per objektin per turizem per te cilin kemi votuar qe te ndertohet ne Bjeshke te Belegut dhe nëse ka ndodhe ajo qka potencoj Florimi dhe i eshte nderruar vendi i ndertimit ateher kjo teme duhet te vjen prap ketu ne kuvend, ndersa ne lidhje me Natyren duhet te potencoj, dhe duke ju drejtuar Natyres ai ka thene qe sikur te kishe qendruar dje deri ne fund te mbledhjes nuk ishe deklaruar keshtu sot sepse me keto deklarata po na njollose te gjithve si kuvend, gjuha jote dje dhe largimi nga mbledhja jane te papranueshme sepse ti duhet me fakte me vertetu ate qe thu, sepse te gjith ne si KPF jemi deklaruar se komuniteti RAE jane te barabarte me ne, në të gjitha fushat, ka nga ata qe jane edhe veteran te luftes dhe jane shum te nderuar per kontributin qe kan dhene.
Natyra Kuçi-thot se dje eshte perdore gjuha raciste kur komuniteti RAE janë qujtë "gabel" dhe Maxhup", sepse edhe shqiptarët kane vra njerz, dhe koha e komandantëve ka mbaruar.
Kryesuesi-thot se nuk pajtohet me vlersimert qe ben ajo, edhe dje eshte thene keshtu ne mbledhje poashtu edhe sot deklarojme se nuk qendrojne punet ashtu si thot ajo dhe se ky komunitet eshte i barabarte me ne dhe jane te respektuar po aq sa te gjithe ne qe jetojme ketu.
Shaban Pejqinoviq,(i nacionalitetit boshnjak, invalid i luftes se UÇK-së) Udheheqes i Zyres per komunitete dhe kthim- ka thene se ne Komunen e Deçanit komunitetet minoritar jane të respektuar dhe të integruar 100%.
Agron Demukaj- edhe nje here ka thene se ai ka menduar ne kontest te kohes se luftës në vitet 98-99 kur na jane djege shtepite ndersa pas çlirimit pas pavarsise se Kosdoves ata qe kan qene te pafajshem dhe nuk kane bere krime kane jetuar me ne ketu dhe jane te barabarte si te gjith te tjerët. Ndersa kërkoi nga Prokurori i shtetit qe te intervistoi znj. Natyra Kuqi e cila dje ne KPF dhe e përsëriti edhe sot ne asamble ku deklaroi se shqipetaret kan vra njerëz, kërkoi qe te deklarohet kënd e kan vra pasi qenka ne dijeni.
Albesa Cacaj-thot se Natyra nuk ka pase qellim tjeter vetem se mu implementu ky plan.
Kryesuesi-thot se te gjith jemi per ate qe me i perkrahe dhe me i ndihmu komunitetet pakice ne Deçan.
Agnesa Vokshi-thot se te gjith ne jemi që me qene te barabarte të gjithë, por fjalen qe e the ti Natyra se edhe shqitaret kane vra njerz, ti per kete deklarim duhet me kerku falje, se na krejt jemi te mendimit qe mos me pase diskriminime, dhe deklarimet e tua nuk qëndrojnë fare.
Florim Mataj-thot se nuk e perkrahi kete mos marreveshje dhe nuk kemi nevoje me i ngrite ato tema ketu dhe kerkoj ka thene ai qe mos ta zgjerojme ma temen.
Kryesuesi- e qiti ne votim rendin e punes te propozuar me ftese me ndryshimet e miratuara ma pare.
Miratohet rendi i punes me ndryshuimet e miratuara si rekomandime te KPF-s me 1 apstenim.
1.Raporti i Drejtorit te Kompanise Higjiena.
Drejtori i Kompanise "Higjiena",Kastriot Hulaj, sqaron se fillimisht i ka ba kerkese Kryetarit te Komunes per ta ndihmuar kompanine ne situaten e krijuar nga pandemia Covid 19, destinimi ka qene falja e bizneseve per dy muaj dhe pagat e puntorve ne vlere prej 21.000.00 euro, keto kane qene pagat e puntorve te kompanise Higjiena te cilet kane punuar pa nderpre gjate kohes se pandemse ndersa Qeveria nuk i ka pershi ne pakon emergjente.
Mehmet Osaj- pyet, sa ki ba raport te hyrave dhe te dalave te kompanise.
Drejtori i kompanise Higjiena-pergjigjet se une raportin e boj por ketu jam me raportu per keto 50.000 euro qe i jan nda kompanise me vendim te kuvendit per te operuar gjate kohes se pandemise, kure do qe ju e shifni te arsyeshme une ju raportoj.
Albesa Cacaj-i drejtohet drejtorit te kompanise se ke thene se edhe ekonomite familjare do te falen per dy muaj, pse nuk ka ndodhe kjo.
Drejtori i Kompanise- thot se kerkesa ime ka qene per 70.000 euro dhe aty kan hy edhe lirimi i ekonomive familjare por ju nuk mi kini miratu aq mjete por vetem 50.000 dhe me ato une e kam pa te arsyeshme me i pagu puntort dhe me i liru bizneset per dy muaj.
Milazim Mushkolaj-thot se sipas llogaritjeve kompanise i kan mbete edhe 11.000 euro nga mjetet qe ka marre nga komuna dhe pyet se qka kini ba me borgjet qe ja kini kompanise publike ne Peje.

Drejtori i ndermarrjes pergjigjet se ato mjete kan mbete ne ndermarrje dhe ne me to kemi krye pune te ndryshme per ndermarrjen.
Mon Selmonaj-thot qe shuma prej 11.000 euro ka mbete si depozit ne ndermarrjen tuaj, ndersa per prishje te kamionit te ndermarrjes me qellim ateher ata duhet me i pagu vet shpenzimet e ndreqjes se kamionit ndersa ju i kini suspendu dy puntor te pafajshem per kete gje.
Drejtori i ndermarrjes-sqaron se ne kontrate te re te punes i shkrune shoferit te kamionit se ai duhet te paguan per prishjet qe behen me qellim, ndersa sa ju perket puntorve te suspenduar 2 jan kthy e nje ende eshte i suspenduar.
Shkelqim Haxhnikaj- thot se kto 11.000 euro nuk ish dashte te futen ne raport sepse nuk jane shpenzuar per qeshtjet per te cilat jane dhene nga komuna, pastaj kerkon nga drejtori qe nese eshte e mundur qe te ndryshohet orari i mbledhjes se mbeturinave ne qytet.
Drejtori-ka sqaruar rreth orarit.
Florim Mataj-thot se me Statut te Ndermarrjes eshte e rregulluar se kure duhet te raportohet ne kuvend, e jo kure te na thirrni ju ne kuvend, ne vazhdim i eshte drejtuar Drejtorit te kompanise Mos e merrni veten si shpetimtare te Kompanise.
Meqense nuk kishte diskutime tjera Kryesuesi e mbylli debatin rreth ketij raporti.
I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Kryesuesi- e ka hape debatin rreth procesverbalit te mbledhjes se kaluar.
Shkelqim Haxhnikaj- ka thene se une e kam propozu lirimin nga pagesa e qerasë të gjitha objektet komunale të dhëna me qera në Komunën e Deçanit deri me 31 dhjetor , jo Florimi siq eshte ceke ne procesverbal.
Albesa Cacaj- thot se nuk e kam votuar une lirimin nga taksa.
Miratohet procesverbali i mbledhjes se kaluar me plotësime, me shumic votash, nje apstenim.
II. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizes Afatmesme Buxhetore (KAB) 2021-2023.
Kryesuesi-e ka prezentu piken pastaj per sqarime fjalën ia kalon drejtorit te buxhetit.
Drejtori i Drejtoris per Buxhet dhe Financa, z.Agron Demukaj- ka sqaruar se Buxheti per vitin 2021 kapë shifren 10,063,818.00€ , per vitin 2022 buxheti eshte 11,702,803.00 € ndërsa per vitin 2023 planifikohet buxhet prej 12,141,111.00 €, brengosese prap mbetet minusi ne arsim ne shumen prej 481.000 € ne kete vit kemi 5586 nxenes dhe 600 punonjes ne arsim, granti i shendetsise eshte i mjaftueshëm por kërkon mjete shtese per paisje te emergjencës, mirëpo jemi ne nje gjendje para nje krize financiare per shkak te gjendjes se krijuar nga covid 19, sa u përket listës se projekteve kapitale nje mori jan ne vazhdim, kemi parapa mjete per projekte te bujqësisë dhe projekte tjera qe paraqiten ne listën qe posedoni.
Florim Mataj-te investimet kapitale te dedikuara per trashëgimi kulturore ka propozuar qe te parashifet rregullimi i nje shtëpie ne fshatin Baballoq, te pozicioni Ndriqimi publik ka pyet se çka përfshinë, te kanalizimi pyet se per cilin kanalizim behet fjale.
Albesa Cacaj- thot se nuk ka ardhe raporti financiar, pastaj thot se te investimet kapitale çdo vit e kemi te njëjtin problem, duke filluar nga fillimi i listës se kapitaleve, te rrugët pse nuk ceket me emër se cilat rruge do te rregullohen dhe sa kilometra kan, te rrugët e bjeshkës- cilat rruge janë, rrugët ne qytet-cilat rruge hyjnë aty, rregullimi i varrezave te deshmorve-ne cilin fshat janë ato, Ujsjellsi i bjeshkës- ne cilën bjeshke eshte ai, mirëmbajtje investive-cilat janë ato, varrezat e qytetit-qka tregon kjo mirëmbajtje apo qka, te pika 14-Ndriqimi publik-ne cilën rruge dhe ne cilin fshat eshte, projektet per turizëm –te behet e qarte cilat janë, Projektet kapitale me qytetar-cilat janë, rryme per bjeshke –ne cilat bjeshke, pastaj ka shtruar pyetjen se si doni me ja ba me problemin e minusit ne arsim.
Milazim Mushkolaj- thot se jini zotuar per restaurimin e spitalit ushtarak ne fshatin Irzniq, pastaj ngrite qeshtjen e rregullimit te rrugës Shaptej-Dubrave.
Kestrim Avdimetaj-thot se ne listen e projekteve kapitale nuk e lejon programi qe te futen ne liste si psh te gjitha rrugët ose ujsjellset dhe te tjerat por mundësisht te na njoftoni këtu se ku janë projektet qe futen brenda nje pozicioni ne listën e investimeve kapitale, ai ka shtuar se eshte mire te behet çdo here plani i menagjimit te projektit.

Ilir Ferizaj- thot si i kini përfshi kapitalet vetëm me ni liste dhe shifrat janë qite vetëm sa per tu rrumbullaksu buxheti.
Drejtori i buxhetit- pergjigjet ne pyetjet e ngritura, ai thot se te trashëgimia e kemi parapa vetëm si kod sepse mundësitë tona buxhetore nuk e përballojnë rregullimin e shtëpive vetëm mundohemi qe te gjejmë burime tjera financimi por duhet ta kemi si kod nëse na ndihmon dikush, te kanalizimet kompetent eshte Ministria e Ambientit por ne po shpresojmë se do te na përkrahin, te gjitha projektet publikohen te kryetari i komunës mirëpo per Llotin nr.3.ktyetari eshte i pajtimit mi thirre nje mbledhje kure ju te doni dhe me ju njoftu hollësisht me te gjitha projektet sepse sistemi nuk na lejon me shkru ma shum ne liste dhe me i ceke te gjitha projektet qe hyjnë ne nje pozicion, per bjeshke jemi ne hartim te projektit, te mirëmbajtja investive hyn mirëmbajtja verore dhe dimerore e rrugëve, te varrezat e qytetit e kemi bere nje projekt por po kushton shum,
Mehmet Osaj- ka thene se varrezat e qytetit nuk po trajtohen mire nga qytetaret dhe po e bëjnë varrimin sipas dëshirës pa plan.
Drejtori i buxhetit- sqaron per rryme te bjeshkës, ai ka thene se ne projekt buxhet eshte projekti per rryme ne bjeshke te Belegut dhe bjeshkën Deçan-Carrabreg, per arsim çdo here ne tre mujorshin e fundit lejohen trasferet dhe minstri mund ta mbulon minusin, raporti financiar eshte i gatshëm dhe muajin e ardhshëm do te jau sjellim por kjo eshte shtyre per shkak te kushteve te krijuara nga Covid 19, rruga Shaptej –Dubrave duhet te shiqojme a eshte ne Llotin nr.3., plani i menagjimit te projektit eshte mire te behet çdo here, ndërsa per shifrat e rrubullaksume pa studim-KAB na mundëson vetëm me i parapa kufijt dhe me i nxan si kode pa çmime fikse por kur te vjen Qrkorja e II-të buxhetore atëherë sakte caktohet çdo shifër.
Lirije Zukaj- te pika nr.4 e kapitaleve pyet se a e përfshinë kjo edhe fshatrat sepse nga Belegu vijnë shum femij ne shkolle ne Deçan.
Drejtori i buxhetit –per gjigjet se ndërtimi i shëtitores dhe trotuareve ne vitin 2021 parashifet vetëm kah Manastiri, meqë nuk kemi buxhet ma shum.
Mon Selmonaj- thot se te Zyra e Kuvendit janë parapa 12.000 euro per mallra dhe shërbime dhe konsideroj se këto jan shum, , te rrugët e bjeshkës- nuk përshkruhet se cilat kan qene vjet dhe cilat janë ne radhe, ujsjellsi ne bjeshke nuk dihet ne cilën bjeshke , varrezat e qytetit eshte shkruar gabim sepse këto janë varreza komunale mirëpo duhet te rregullohen si duhet, ndriqimi publik-kërkon sqarim ne cilat lokalitete behet fjale, rruga Prejlep- Rastavice-Babalłloq a eshte ne planifikim.
Kryesuesi- ka sqaruar per shpenzimet e kuvendit per mallra dhe shërbime se si shpenzohen.
Drejtori i buxhetit – sqaron se 20.000 euro kapitale janë te evidentuara te administrata e shendetsise, rruga Prejlep-Rastavice –Baballoq nuk di a eshte ne projekt por kjo gje duhet te evidentohet, , sa ju përket rrugëve te bjeshkës –ai ka qene projekt tre vjeqar dhe disa rruge jan krye e disa janë ne planifikim,.
Albana Avdiu- thot se pajtohem me shumicën e diskutimeve , psh pajtohem me diskutimin e Kestrimit qe tha se kështu duhet te behet planifikimi dhe per këto u dhan sqarime, por me shqetson rritja e buxhetit nga viti ne vit dhe pyes se si ki mendu se mund ta realizon kete gje.
Drejtori i buxhetit- sqaron se ne si komune na vjen planifikimi i buxhetit nga Ministria e Financave e pastaj varet se sa na mund ta realizojmë planin.
Erdogan Dautaj- thot se pajtohem me diskutimin e Kestrimit dhe te Albanes por bile me i pas ceke se per ku behet fjale kishte qene shum e kuptueshme, mirëpo meqenëse u debatua mjaft sepse bene shum pyetje dhe u dhan sqarime nga drejtori per te gjitha , konsideroj se eshte shterre debati dhe kerkoj qe kjo pike te qitet ne votim.
Mon Selmonaj- thot se Ekzekutivi eshte obligativ me na njoftu per çdo gje.
Valdet Nuraj- thot se si pike e pare kishte qene mire sot me qene ne mbledhje te gjith drejtorët, pastaj kërkon qe te rregullohet Pallati Kultures sespse i plotëson te gjitha kriteret per zhvillimin e aktiviteteve rinore prandaj ne kete pike nuk pajtohem me nr.6 ne listën e projekteve kapitale (Ndertimi i Qendres rinore).
Mehmet Osaj- kërkon raport detal per Llotet qe i kemi dhene ne shfrytëzim afatgjate dhe te shofim se çka kemi fituar si komune.

Drejtori i buxhetit- thot se si Ekzekutiv jemi te gatshëm qe te vijmë ne Asamble me krejt dokumentacionin dhe te ju njoftojmë per planifikimin e investimeve kapitale detalisht, ndërsa sa ju përket Lloteve –per 5 Llotet, kane me ardhe raportet konkret.
Mehmet Osaj- ka ngritën qeshtjen e zhavorit qe e merr Compania Lika per shtruarjen e rrugës Deçan-Plave.
Kryesuesi- tha se u debatua mjaft dhe u dhan sqarime ne te gjitha pyetjet e shtruara, prandaj e qiti ne votim KAB 2021-2023.
Antaret e Kuvendit e miratuan Kornizen Afatmesme Buxhetore 2021-2023 me shumic votash, rezultati i votimit ishte 14 vota pro(pozita), 6 kunder(opozita).
III. Shqyrtimi i raportit per aktivitetet e Komunes gjate kohes se pandemise COVID -19.
Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj ka shtuar se materiali ka ardhe shum i detajuar per çdo gje.
Drejtori i drejtoris për Sherbime Publike, Izet Zenuni, njeherit edhe kryetari Keshillit emergjent ne kohen e pandemisë Covid 19, sqaron per te gjitha aktivitet e komunës gjate kësaj kohe, kohe e cila nuk ka qene e lehte, mirëpo fale ngazhimeve tona eshte duke shkuar bukur mire ka thënë ai, per kete falënderim te veçante per donatoret qe na kane ndihmuar ne kete kohe te veshtire, situatën e kemi menagjuar me mbeshtejen e buxhetit komunal dhe te donatorve ndërsa ndihma e qeverise per komunën e Deçanit eshte zero euro.
Kryesuesi- meqenëse nuk kishte diskutime tjera, e mbylli debatin rreth raportit pas sqarimeve te dhëna nga drejtori.
IV. Vlersimi ekonomik i ndikimit te pandemise Covid 19.
Kryesuesi- e ka prezentu temën pastaj per sqarime fjalen ia ka dhene drejtoreshës se Zhvillimit Ekonomik, znj.Fitore Hulaj, e cila ka dhene sqarime te mjaftueshme.
Meqense nuk kishte diskutime Kryesuesi e mbyllë debatin rreth kësaj teme.
V. Aprovimi i mjetve financiare per projektin Zhvillimi i shtegut te ngjitjes sportive "Via Ferrata Decani", ne shumen prej 20.000 euro.
Kryesuesi-e prezentoj kete pike pastaj per sqarime fjalën ia ep drejtoreshës se zhvillimit Ekonomik, znj.Fitore Hulaj, e cila ka sqaruar se planifikimin e zhvillimit të projektit për ndërtimin e shtegut Via Ferrata e ka bërë shoqata bjeshkatare "Kosovo Mountain Club" me perfaqsus Adriatik Gacaferi, ndërsa financimi do te kryhet ne bashkpunim me Zyrën vicerane SWISS CONTAKT në Kosonë, i cili do te kushton 40.000 €, dhe do te financojmë nga 20.000 € ne si komune dhe 20.000 € zyra zvicerane,mjete qe do te shkojne te zyra zvicerane SWISS CONTAKT në Kosonë, te cilët do ti kryejne te gjitha punet, sot me kete material jane sjelle te gjitha kordinatat e sakta se ku gjinden pronat neper te cilat kalon Via Ferrata poashtu eshte edhe kalkulimi financiar.
Lirije Zukaj- e përgëzon drejtoreshën per punën e bere pastaj ka shtruar pyetjen , se a ka me pase zip llain Via Ferrata.
Drejtoresha pergjigjet se kete vit vetëm Via Ferrata e mandej do te shofim.
Me vendim unanim miratohen mjete financiare ne vlere prej 20.000 € per projektin Zhvillimi i shtegut te ngjitjes sportive "Via Ferrata Decani".
VI. Ndarja e mjeteve financiare per hapjen dhe mirembajtjen e kanaleve te ujitjes ne bashkefinancim me K.R.U."Drini i Bardhe", ne shumen prej 11,000 euro.
Kryesuesi- e prezenton piken pastaj fjalën ia kalon drejtorit te drejtorisë per BPZHR, z.Rifat Stojkaj, i cili ka sqaruar se behet fjale per nje projket ne bashkëfinancim me KRU Drinin e Bardhe, ne te cilin Komuna do te merr pjese me 11.000 € ndërsa Drini i Bardhe me 10.000 €, me këto mjete do të bëhet hapja dhe mirëmbajtja e kanaleve te ujitjes dhe parashifet qe per kete vit te lirohen fermerët nga pagesa e ujit te ujitjes se tokës.
Mon Selmonaj- pyet se cilat kanale do te pastrohen dhe a janë te njëjta çdo vit apo te ndryshme.
Drejtori- ka thene se listen e kanaleve qe do te pastrohen do te jau sjelli mbledhjen tjetër dhe nga këto kanale do te ujiten 250 ha. toke.

Kryesuesi-meqenëse nuk kishte diskutime tjera e qiti ne votim kërkesën per ndarjen e mjeteve financiare per hapjen dhe mirembajtjen e kanaleve te ujitjes ne bashkefinancim me K.R.U."Drini i Bardhe", ne shumen prej 11,000 euro, antaret e Kuvendit e miratuan njëzëri ate.
VII. Shqyrtimi i kerkeses se Keshillit te Bashkesise Islame ne Deqan per ndertimin e Xhamise ne fshatin Rastavice, ne ngastren kadastrale nr.P-722-0.
Kryesuesi-edhe nje here potencon se kjo pike hiqet nga rendi i ditës me rekomandim te KPF-së.
VIII. Shqyrtimi i kerkeses se OVL ne Deçan dhe marrja e vendimit per emertimin e vendit Batalioni Gardist "Shkelzen Haradinaj" ne vendin e renies se 16 Dëshmorëve në Bjeshkë të Belegut.
Kryesuesi- e prezentoj piken dhe e hapi debatin rreth saj, mirëpo meqenëse nuk kishte diskutime ai e qiti ne votim, antaret e Kuvendit njëzëri e miratuan kërkesën e OVL ne Deçan dhe muaren vendim qe vendi i renies se 16 Dëshmorëve ne Bjeshke te Belegut te emrohet Batalioni Gardist "Shkelzen Haradinaj".
IX. Plani i Veprimit për Komunitetet Egjiptian, Ashkali dhe Rom në Komunën e Deçanit 2020-2022.
Kryesuesi-e prezentoj kete pike pastaj e hapi debatin , mirëpo nuk kishte diqka per te shtuar nga asamblistët.Kryesueis- e qiti ne votim kete pike, antaret e Kuvendit njëzëri e miratuan Planin e Veprimit për Komunitetet Egjiptian, Ashkali dhe Rom në Komunën e Deçanit 2020-2022.
X.Zhvendosja e Mullirit te Shabanaj.
Kryesuesi- e prezentoj kete pike dhe ka sqaruar se në KPF eshte shqyrtuar me propozimin e Kryetarit te Komunes dhe ketu ne Kuvend ka ardhe me rekomandim te KPF-se qe te shqyrtohet si pike e veçantë e rendit te ditës.
Mon Selmonaj-kerkon sqarim per vendin se ku planifikohet te behet zhvendosja e Mullirit Shabanaj.
Kryetari i Komunes, zotëri, Bashkim Ramosaj- ka sqaruar se kjo teme eshte shqyrtuar nje here ne mbledhjen e Kuvendit te dt.30.04.2019, dhe kjo eshte bere per nevoja te zgjerimit te rrugës kryesore ne qendër te qytetit te Deçanit, dhe ne te njëjtën mbledhje eshte marre vendim qe te shpallet prone me interes publik parcela nr.1236-0 ZK Deçan ne te cilën eshte i ndërtuar mulliri Shabanaj, dhe njëkohësisht edhe vendimi qe te behet zhvendosja e Mullirit ne nje vend tjetër, mirëpo meqenëse na eshte pervjedhe përfshirja e debatit per zhvendosje si dhe marrja e vendimit per zhvendoje, tani jemi detyruar qe edhe nje here ta qesim ne kuvend vetëm Zhvendosjen e mullirit, i cili propozohet qe te zhvendoset ne hapsirat pas Lapidarit Luan Haradinaj.
Meqense nuk kishte diskutime tjera, kryesuesi e qiti ne votim, antaret e Kuevendit njëzëri e miratuan propozimin per zhvendoje te mullirit Shabanaj.
XI.Kerkesa e Komunitetit te fshatit Strellc e prezentuar nga Valdet Nuraj per rivarrim te deshmorve ne vlere prej 42.000 euro, tash do te zotohen 5000 euro ndersa te tjerat ne shtator do te planifikohen me buxhet.
Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj per sqarime fjalën ia ep Valdet Nuraj, i cili ka sqaruar se familjarët e deshmorve kan kërkuar qe ti bashkojnë dhe ti rivarrosin te gjith deshmoret bashk ne nje vend, te Lapidari i ndërtuar ne fshatin Strellc te Ulet, ne e kemi bere nje paramase dhe sipas kësaj paramase na nevoiten 42.000 € per te bere rivarrosjen e këtyre deshmorve, kerkoj përkrahjen tuaj ne kete qeshtje ka thene ai.
Mon Selmonaj- kërkon njoftim per sa deshmore behet fjale.
Valdet Nuraj- sqaron se behet fjale per te gjith deshmoret e fshatit Strellc i Ulet per te cilët duhet te behet rivarrimi.
Erdogan Dautaj-thot se e përkrahi kërkesën e fshatit Strellc te prezentuar nga Valdet Nuraj per rivarrimin e deshmorve te Lapidari i fshatit, pastaj ai ka bere kerkese qe te ndahen mjete financiare per rregullim te varrevae te deshmorve edhe ne fshatin Carrabreg.
Kryesuesi- e qiti ne votim kërkesën e fshatit Strellc te prezentuar nga Valdet Nuraj per rivarrim te deshmorve te Lapidari i fshatit ne vlere prej 42.000 €, antaret e Kuvendit e miratuan ate njëzëri, ndërsa sa i përket ekzekutimit 5000 € nga shuma e përgjithshme prej 42.000 € do te ekzekutohen

menjëherë ndërsa shuma e mbetur prej 37.000 € do te planifikohen ne shtator me buxhetin e vitit 2021 dhe do te ekzekutohen ne vitin fiskal 2021 .

XII.Te ndryshme.

Mon Selmonaj- ka prezentuar nje kerkese te Shkolles Fillore "Rexhep Kadrijaj" ne Rastavic per 100 m kubza per rregullimin e dyshemes se nje klase verore ne shkolle.

Kryetari- ka thene se per kete qeshtje kemi biseduar ma herët me strukturat e shkollës dhe jemi marre vesh qe ne do te jau ndërtojmë kete klase dhe kjo eshte pune e kryer.

Milazim Mushkolaj-thot se mbledhjen e kaluar jemi pajtuar qe ta thirrim drejtorin e Kompanise Ujsjellsi këtu ne Kuvend per te na sqaruar per mungesën e ujit ne ujsjellsin e 11 fshatrave, dhe siq po shifet ai sot nuk ka ardhe.

Kryetari- thot se une mund te jau bej nje ftese përfaqësuesve te kompanisë dhe me ardhe ne nje mbledhje te veçante per te referuar per problemet me ujin e pijes ne 11 fshatra, mirëpo ka potencuar Kryetari se problem kryesor per ujë te pijes për ne mbetet ujësjellësi i rajonit te Vokshit dhe i Strellcit, mirëpo ju mund te veproni si te doni te caktoni ndonjë date per takim me udheheqsine e kompanisë ose edhe ndonjë komision mund ta formoni.

Florim Mataj- thot se edhe une e kam pergadite nje fjalim per ndërtimin e nje objekti per turiste ne Bjeshke te Belegut dhe pyet se a po ndërtohet ne Bjeshke te Belegut ku eshte votuar apo ne bjeshke te Baballoqit, ai ka kekruar qe edhe Suka e Baballoqit ti kthehet fshatit Baballoq.

Kryetari- ka sqaruar se bëhet fjalë për ndërtimin e një Qendre Turistike në Bjeshkën e Belegut, në parcelën nr.0060-0, Çertifikata P-70505069-00060-0, Zona kadastrale Irzniq II, ne te cilin per here te pare Komuna e Deçanit hyn ne bashkëpunim ndërkufitarë me Komunën e Andrijevicës të Malit të Zi, që në theks të veçantë ka të bëjë me zhvillimin e Turizmit në Komunën e Deçanit, dhe jemi kah temtojme diqka ne interes per krejt komunën, ne kete projekt i kemi diku 22 aktivitete qe do te ndodhin ne Gryke , nga Komuna ndahen per kete projekt 30.000 € ndërsa projekti kushton 3 milion.

Agnesa Vokshi – ka ngrite qeshtjen ujësjellësit te rajonit te Vokshit dhe mungesën e furnizimit me ujë të pijes të krejt këtij rajoni.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse:
Dyke Llolluni

Verifikon procesverbalin:

Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj

Asambleja
01.Nr.VII
Deçan,dt.13.07.2020

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e VII-të me radhë të Asamblesë Komunale, mbledhje e jashtëzakonshme e mbajtur me dt.13.07.2020.

Në mbledhje ishin prezent:22 anëtarë të asamblesë, Kryetari i Komunës, 9 drejtor të drejtorive komunale, OJQ, mediat.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, zotëri Haki Shehaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky rend pune:

1. Reagimi i Kuvendit Komunal të Deçanit në raport me aktakuzat e fundit të Gjykatës Speciale.

Kryesuesi duke i përshëndetë pjesëmarrësit e hapi mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit, mbledhja e VII-të me radhë, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje janë prezent 22 asambleist (mungojnë:Mustafë Selmanaj, Besjana Ukëhaxhaj, Uran Tolaj, Rejhana Tolaj, Ilir Ferizaj).

Kryesuesi- ka thënë se kjo mbledhje eshte ftuar me iniciativën e grupit parlamentar i PDK-së i cili eshte mbeshtete me nenshkrime nga gjithsejt 12 asamblist, ne do te debatojmë sot per kete teme mirëpo ne fund duhet a nxjerrim nje deklarate te kuvendit ne te cilën ne i shprehim mospajtimet tona rreth kësaj qeshtje, dhe per nxjerrjen e deklaratës propozoj qe te formohet nje komision i kuvendit qe merret me hartimin e deklaratës dhe ne fund ajo do te miratohet ne kuvend.

Ne vazhdim formohet komisioni per hartimin e deklaratës ne kete përbërje:1.Kestrim Avdimetaj-PDK, 2.Erdogan Dautaj-AAK,3.Shkelqim Haxhnikaj-LDK, 4.Natyra Kuçi-PSD, 5.Musa Berisha – Ekzekutivi.

Perberja e komisionit miratohet njëzëri .

Kryesuesi- pas formimit te komisionit ka thene se edhe pas 20 viteve lufte po ftohen nga Gjykata përfaqësuesit e UÇK-së e jo ata qe e bene krimin e vertete ne Kosove, Permes shpifjeve po tentohet te njolloset UÇK-ja, por jemi te bindur se edhe kete here do te dëshmohet lufta e pastër e UÇK-së.Ftesa per presidentin dhe ish-kryeparlamentarin edhe nje here do te dëshmon luftën e pastër te UQK-se siq ka dëshmuar edhe me pare me rastin e kryeministrit Haradinaj dhe bashkëluftëtarëve tjerë, do te dëshmohet pafajësia dhe lufta e drejtë e UQK-se, mirëpo edhe sa mund dhe sakrifice na duhet ne qe te dëshmohet e vërteta per shtetin e Kosoves.

Kryetari i Komunes-i eshte drejtuar Kuvendit duke thene se jemi sot këtu ne seance te jashtëzakonshme per te shprehur shqetësimin tone, dhe per te dhene rekomandimet e njëkohësisht mbështetjen tone lidhur me shqetësimin per rreth situatës paradoksale te krijuar kohëve te fundit.E them paradoksale , sepse te akuzosh Ushtrine Çlirimtare dhe krerët e saj per krime lufte mbi bazën e hipotezave dhe supozimeve te qëllimta, e qëllimkëqija eshte përtej paradoksit.Ne jetën tone nga viti 1999 e deri me sot, 21 vite interval kohor pas çlirimit, kemi reaguar, kemi protestuar, kemi dhene mendimin tone dhe jemi përpjekur ta mbrojmë te drejtën tone per liri dhe shtet, duke mbrojtur me te drejte bartësen kryesore te sakrificës tone per çlirim, Ushtrine Çlirimtare te Kosoves dhe udheheqsit e kësaj ushtrie.E ritheksoj edhe nje here nje te vertete neper te cilën kemi kaluar nen okupimin shovinist serb, okupimi ma monstruoz dhe me i egër, nga njerzit dhe shteti ma gjakatar ne Evropë dhe ne kete pjese te botes.Na kujtohen kush e ka nje moshe, burgosjet,

helmimet e nxënësve, vrasjet ne masë në protesta, dëbimet nga puna, dhunimet, zhberjet e qyteteve dhe aplikimi i operacioneve duke i bere rrafsh me toke. Masakrimet, vrasjet e fëmijëve, te pleqve dhe spastrimet duke e dëbuar te gjithë popullsinë e kosoves, duke bere gjenocid mbi ne, duke shkatrruar trashëgiminë tone historike e kulturore, dhe sot ku jemi, jemi perballe nje padrejtësie te radhës ku akuzohen themeluesit e Ushtrise Çlirimitare te Kosoves, presidenti i vendit,z.Hashim Thaqi e ish kryeparlamentari z.Kadri Veseli, te cilët nuk bene asgjë me shume perveq se u organizuan, luftuan per lirinë e vendit te tyre, kundër regjimit me te egër te shekullit te kaluar. Kemi pasur situata te tilla edhe me herët, qofte ne rastin e Limajt, Haradinajt, grupit te Llapit, te Drenices e te Dukagjinit, te ashtuquajtura padrejtësisht ne kohen kur UNMIK-u po e bënte gjoja drejtësinë ne kete vend, apo Haga 1 e Hagat ne rastin e komandantit Ramush Haradinaj, si Tribunal Nderkombetar per krime lufte ne ish Jugosllavi. Vlersoj tha Kryetari, se sado qe eshte e padrejte, eshte edhe paradoks gjyqësor, historik e faktik, e si i tille i papranueshëm per popullin liridashës te Kosoves.Akuzimi i çlirimtarve nga çfardo qofte gjykate, e kur kihet parasyshe se kriminelet e vertete serb i thurin këto aktakuza, dhe ate jo vetëm, por ne bashkëpunim me tere ata qe sja duan te mirën këtij vendi, nga këtu u bej thirrje institucioneve te shtetit tone qe te bëjnë nje veprim qe do te ishte nje kerkese qe krejte zyrat e huaja te dorzojne te dhënat qe posedojnë per krimet e ushtruara nga regjimi serb ne Kosove, falenderoj ata qe kane iniciuar thirrjen e kësaj mbledhje ka përfunduar Kryetari.

Mon Selmonaj-ka thene qe sa ma shum qe Kosova po i ofrohet mundësisë qe përmes dialogut t'i japë shanse paqes me Serbine duke i hapur rruge te ardhmes dhe progresit per te dyja shtetet, zhvillimet politike te ditëve te fundit kane marre kahje te papritur dhe po e vene ne rrezik dialogun dhe paqen.Pretendim akuza per krime lufte nga zyra e prokurorisë speciale pa u konfirumuar ne gjykatën e dhomave te specializuara këto dite, ndaj dy figurave kryesore te Ushtrise Çlirimtare te Kosoves, Presidentit te republikës se Kosoves , z.Hashim Thaçi dhe kryetarit te PDK-se, z.Kadri Veseli dhe paralajmërimi se ka edhe te tjerë ne kete akuze ishte nje goditje e rende per Kosoven dhe krejt e papritur vetëm dy dite para dialogut ne shtëpinë e bardhe.Ky publikim i pretendim akuzës, pa qene e konfirmuar nga gjykatësi i procedurës paraprake, eshte nje paragjykim politik dhe krejtësisht i motivuar me qëllime politike, pa kurrfarë baze juridike, thjeshte nje gjykim politik i dy figurave te larta shteterore.Ky akt cenoj pariparueshëm kredibilitetin e nje gjyqësie nderkombetare.Publikimi jashtë procedural i pretendim aktakuzës ne momente paqeje e dialogu mendojmë se atakon fundamentin e procesit te dialogut.Vlera e lirisë se Kosoves sot eshte kontribut dhe vlere e UÇK-së. Lufta e UÇK-se dhe pastërtia e saj e beri boten demokratike te radhitet ne anën tone, e solli Naton ne Kosove.Kjo pastërti e luftës se UÇK-se u dëshmua edhe ne dy procese gjysore te mëhershme ne Hage, ku pjese e këtij procesi ishin dy figura emblematike te UÇK-se, z.Ramush Haradinaj dhe z.Fatmir Limaj, te cilët dëshmuan luftën e drejt per liri, pastertinë e saj, duke respektuar ligjet dhe konventat nderkombetare te luftës. Ne te gjithë e dijme qe Serbia eshte ajo qe ka hartuar lista dhe përpiluar dosje, qe ka bere lufte te vazhdueshme kundër luftetarve te UÇK-se dhe ajo nuk pajtohet kurrë qe ata njerz ti kete perballe ne tavolinën e dialogut.Serbia qe nga çlirimi i Kosoves per ta fshehur gjenocidin qe beri mbi popullin shqiptar te Kosoves përdori propagandat me te ndryshme per te penguar shtetësinë e Kosoves deri sa e shpiku edhe shtëpinë e verdhe ne Shqiperi qe ngarkon UÇK-ne me akuza te supozuara dhe arbitrare per trafikim organesh njerzore.Serbia përmes argatve te saj si Dick Marty, raportin e përpiluar nga Rusia dhe Serbia arriti ta miratoj ne Asamblene Parlamentare te Keshillit te Evropes, duke e bere obligim per shtetin e Kosoves qe te perballet edhe me kete padrejtësi te radhës.Ekzistenca jone shekullin e kaluar me dhjetëra here u vu në pikpyetje përmes dhunes sistematike si ndjekje , dëbim nga vatrat tona, burgosje dhe vrasje deri ne gjenocid te cilat nuk mjaftuan që ne bankën e te akuzuarve te kemi Serbine dhe te jap përgjegjësi per mijëra vrasje e përdhunime ne luftën e fundit, per fatin e mijëra te zhdukurve dhe per 400 masakrat e shkaktuara. Ndersa sot përkundër te gjitha këtyre kemi nje gjykate te njëanshme qe me pretendimet serbo- ruse po përpiqet qe UÇK-ne dhe liderët e saj ti veje para pergjegjsise per krime te supozuara dhe pa asnjë baze, dhe kur akuzohen padrejtësisht komandantet e zonave dhe kjo nuk eshte lufte kundër individve por lufte kundër

UÇK-se.UÇK eshte dhe do te mbetet nismëtarja e lirisë, ajo qe inspiron gjenerata, dhe une dhe te gjithë ne, kemi te drejte te ngrisim zërin e arsyes ne mbrojtje te luftetarve te lirisë ne mbrojtje te luftës se pastër te UÇk-së.Çdo qytetar i republikës se Kosoves por edhe bota demokratike e dine se këto akuza janë te padrejta dhe si te tilla do te hudhen poshtë. Sot me shum se kurrë na duhet uniteti ne mes veti, na duhet pune e përbashkët, sakrifice e përbashkët, unitet i qëndrimeve dhe veprimeve, kur eshte qeshtja e mbrojtjes se interesave te shtetit tone. Si iniciues te kësaj seance te jashtëzakonshme ju ftoj te gjithëve te punojmë se bashku ne hartimin e nje deklarate te përbashkët kundër pedrejtesive qe po u behen luftetarve te UÇK-se dhe per fuqizimin e vlerave te luftës se pastër te UÇK-se, fjalimin e tij e ka përfunduar me fjalët Rrofte Ushtra Çlirimtare e Kosoves.

Agnesa Vokshi- ka thene qe sot nga kjo foltore une po flas me dhimbje si nje vajze e atij prindi qe serbia e ka denu me 20 vjet burg, po flas si nje vajze qe Serbia ia ka vrarë xhaxhanë ne dere te shtëpisë, nuk e di a i kan mëndu ata ndonjëherë ata femij qe janë rritë pa prind, ato gra te reja qe janë plake pa burra, ata prind qe kanë vuajtur deri në vdekje pa pra per djemt dhe vajzat e tyre te burgosur, te vrare dhe te dhunuar. UÇK-ja eshte çlirimtarja e Kosoves dhe krimi vetëm qe ka ba eshte qe e ka mbrojte Kosoven nga ata gjakpirës , e ka mbrojte pragun e shtëpisë se vet.Jemi krenar si brez i ri qe po rritemi per nje UÇK qe e kemi pasur.Ju bej thirrje qe mos te perkrahet kjo gjykate sepse këtu nuk ka vend per krime te cilat janë te supozuara. Nese duhet vërtet te funksionon kjo gjykate atëherë kjo duhet te jete per serbet qe kane krye krimet e verteta.

Florim Mataj- sot ne kete mbledhje te jashtëzakonshme jemi këtu qe se bashku te shprehim indinjatën tone lidhur me vendimet e gjykatës speciale dhe njeherit mbrojtjen e vlerave te luftës se drejte çlirimtare.

Sa e sa gjykata duhet qe ta gjykojnë luftën e Ushtrise Çlirimtare te Kosoves, lufta jone u hetua nga UNMIK-u, EULEX, gjykatat vendore, nga Tribunali i Hages dhe tani gjykata speciale. Lufta çlirimtare ishte nje domosdoshmëri qe lindi nga populli qe te ndaloj nje her e përgjithmonë burgosjet, ketrajtimet, shkeljet e te drejtave te njeriut dhe çrrënjosjen e popullit shqiptar qe serbia me shekuj ushtronte mbi popullin tone. Organizmimi i ushtrisë çlirimitare ne Kosve ishte te mbroje vendin dhe shtëpitë e tyre per dallim nga agresori serb qe tere makinerinë ushtarake e kishte vërsulur mbi popullatën e pafajshme civile ku si pasoje e këtij agresori ne kemi mijra persona te zhdukur, mbi dhjetra mijra persona te vrare, ne mesin e tyre femij pleq dhe gra dhe rreth 20.000 gra te dhunuara , plus demet e mëdha materiale te pallogaritshme. Duke u nisur nga kjo si mund te jete e drejte nje gjykate e tille, a do te ishte e udhës qe Serbia te gjukohet per krimet e kryera ne Kosove, te paguaj dëmshpërblim per demet e luftës dhe te beje kërkim falje. Une besoj ne vlerat e UÇK-se dhe ne luftën e drejte te UÇK-se dhe ftesat e tilla janë pengese ne zhvillimin e proceseve te Kosoves. Mirepo ashtu si ne gjykimet tjera edhe kësaj radhe luftetaret tone do te dëshmojnë pafajsine.Une si pjestar i UÇK-se konsideroj se pjesa me e lavdishme e jetës sime ishte ti shërbej vendit tim dhe ndihem shum krenar per te qenurit UÇK dhe per luftën e drejte qe beri UÇK.

Kestrim Avdimetaj- fillimisht si iniciues i kësaj mbledhje falënderon asamblistët per përkrahje, pastaj ka shtuar se eshte e papranueshme qe te përballemi me nje padrejtësi si kjo. Lufta e UÇK-se eshte e pastër si loti ka thene ai. Krimet e Serbise janë shum te dukshme ne Kosove dhe per kete janë faktet e pamohueshme qe tregojnë numri i te vrarëve dhe te dhunuareve. Ndërsa tash ne kete proces te padrejte ndaj neve , Presidenti dhe ish Kryeparlamentari do ta mbrojnë vlerën e madhe te luftës se UÇK-se, respekt te pafund per luftën e drejte te UÇK-se ka përfunduar ai.

Albesa Cacaj- ka thene qe si LDK besojmë thelle qe lufta e UÇK-se ishte e pastër, prandaj si LDK e mbështesim kete iniciative dhe do ta mbështesim deklaratën qe do te nxirret nga ky Kuvend.

Erdogan Dautaj-ne emër te grupit parlamentar te AAK-se thot se e përkrahim iniciativën e Kestrimit dhe grupit te PDK-se me mbështetjen e te gjitha grupeve parlamentare.Theksojme se lufta e UÇK-se per mbrojtjen e pragut te shtëpisë ishte lufte e drejte dhe e pastër per çlirimin e Kosoves kundër forcave paramilitare dhe ushtarake te serbise , te udhëhequr nga kryekasapi i ballkanit Sllobodan Millosheviq.Andaj e vlerësojmë te paprecedent veprimin e Zyres se prokurorit te gjykatës speciale per ta publikuar njoftimin per nje aktakuze te pakonfirmuar nga

gjyqtari i procedurës paraprake ndaj presidentit te Kosoves z.Hashim Thaqi dhe kryetarit te partisë Demokratike te Kosoves z.Kadri Veseli.Poashtu jemi kunder gjykimit selektiv vetëm per ushtaret e UÇK-se, ku UÇK kishte bere lufte te drejte çlirimtare per çlirimin e vendit te vet ndërsa Serbia ishte okupatore.Poashtu ju jemi mirënjohës miqëve ndërkombëtar te udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara te Amerikes per mbështetjen e pa rezerve per çlirimin e Kosoves.
Ne vazhdim Komisioni i Kuvendit i formuar pak me herët tërhiqet per te hartuar Deklaraten qe kundërshton akt akuzat e Gjykates Speciale.
Pas pauzës, Kuvendi ka filluar me pune dhe Kryesuesi e ka ftuar njërin nga antaret e Komisionit qe ta lexojnë deklaratën .
Ne emër te Komisionit, Kestrim Avdimetaj e lexon deklaratën, ne tekstin si ne vijim:

Në bazë të Nenit 4 dhe 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti iii / nr. 28 / 04 qershor 2008), Nenit 40 të Statutit të Komunës së Deçanit paragrafi I, Kuvendi i Komunës se Deçanit, në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më datë 13.07.2020, miraton këtë:

D E K L A R A T Ë

1. Konfirmojmë qëndrimin tonë dhe bindjen e paluhatshme se lufta mbrojtëse e qytetarëve të Kosovës, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, dhe e përkrahur nga forcat e NATO-së, ishte luftë e drejtë dhe e pastër për çlirimin e Kosovës kundër regjimit gjenocidal të Sllobodan Millosheviqit, forcave ushtarake, policore e paramilitare të Serbisë në Kosovë.

2. Vlerësojmë të paprecedent veprimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për të publikuar njoftimin për një aktakuzë të pakonfirmuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake ndaj dy prej liderëve kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli.

3. Shprehim shqetësimin se ky veprim i Zyrës së Prokurorit të Specializuar përbën edhe shkelje të të drejtave të njeriut, si dhe është në kundërshtim të plotë me parimin themelor të drejtësisë, atë të prezumimit të pafajësisë.

4. Ritheksojmë se lufta mbrojtëse e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe do të mbetet përherë e tillë. Ajo nuk mund të njolloset asnjëherë. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta çmojë lart bashkëpunimin e institucioneve kosovare dhe ish-pjesëtarëve të UÇK-së me institucionet e drejtësisë ndërkombëtare përgjatë këtyre njëzet vjetëve, përfshirë Dhomat e Specializuara. Në gjithë këto procese është dëshmuar pastërtia e luftës së popullit shqiptar për liri e pavarësi.

5. Njohim dhe vlerësojmë lart sakrificën, angazhimin dhe kontributin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të mbështetur nga NATO, e të udhëhequr nga SHBA-të dhe aleatet e saj, për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Solidarizohemi dhe shprehim njëzëri mbështetjen e plotë për z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli, të cilët janë ndër themeluesit dhe udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe shprehim besimin e palëkundur për pafajësinë e tyre.

6. I konsiderojmë përpjekje të padrejta dhe të rrezikshme, por të parealizueshme, tendencat për ta kriminalizuar luftën e drejtë dhe të lavdishme të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Refuzojmë çfarëdo përpjekje për ta etiketuar UÇK-në si agresore;

7. E vërteta për historinë e popullit shqiptar nuk mund të deformohet dhe as të tjetërsohet nga ata që pretendojnë për t'i barazuar viktimat me kryesit e krimeve serbe. Kosovën nuk mund ta dobësojë askush dhe të ardhmen e saj euroatlantike nuk mund ta devijojë dhe as ta ndalë asnjë përpjekje.

8. Si përfaqësues të qytetarëve, të zgjedhur në mënyrë demokratike, bëjmë thirrje për unitet mes njerëzve dhe bashkërendim të angazhimeve ndërmjet partive politike për të ruajtur shtetin e Kosovës, vlerat e luftës dhe pastërtinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Komisioni për formulimin e Deklaratës:

1. Musa Berisha (Ekzekutiv) _____
2. Erdogan Dautaj (AAK) _____
3. Natyra Kuqi (PSD) _____
4. Kestrim Avdimetaj (PDK) _____
5. Shkelqim Haxhnikaj (LDK) _____

Kryesuesi i Kuvendit e qiti ne votim deklaratën e hartuar nga Komisoni, antaret e kuvendit me vendim unanim e miratojnë ate.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.
Procesmbajtëse:
Dyke Llolluni

Verifikon procesverbalin:

Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj